

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XVIII, nr. 5486  
E shtunë, 26 maj 2018  
çmimi 0.40 €

## Veseli: Kosova dhe Shqipëria po ecin sigurt drejt BE-së

Kryeparlamentari Kadri Veseli tha në Tiranë se Kosova dhe Shqipëria tashmë e kanë të qartë aspiratën dhe rrugën të cilën duhet ndjekur për ta arritur synimin e përbashkët - integrimin euroatlantik, duke shtuar se Kosova është në pritje të hapit vendimtar të BE-së për t'i liberalizuar vizat për qytetarët e Kosovës



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", SHKËLZEN MALIQI

## S'ka kohë për të eksperimentuar me dialogun Kosovë - Serbi

Analisti politik Shkëlzen Maliqi ka vlerësuar se opozita nuk është unike dhe nuk ka disponim për ngritjen e mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë. Ai ka thënë se disa parti nuk janë të gatshme për zgjedhje dhe se shumicës i konvenon një qeveri e "mekët", as mish as peshk. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Maliqi ka theksuar se presidenti Thaçi nuk është figurë e pazëvendësueshme në

dialogun me Serbinë por, sipas tij, nuk ka kohë të eksperimentohet dhe të shkaktohen vonesa në këtë proces. Maliqi ka vlerësuar se ideja për zëvendësimin e Thaçit nuk motivohet që dialogu të përfundojë me sukses, por që ai të rrënohet. Sipas tij, nëse partitë mbesin të përcara rreth dialogut, do të ketë vonesa të panevojshme dhe Kosova do të dalë joserioze karshi pritjeve të faktorëve ndërkombëtarë



### AKTUALE

**HARADINAJ: NJOHJA NGA VATIKANI ISHTE FOKUS I BISEDËS ME PAPËN** F.7

**BËHEN PËRGATITJET PËR TESTIN E MATURËS NË RAJONIN E GJILANIT DHE TË FERIZAJT** F.5

**DEPUTETËT DËNOJNË VDEKJEN E 14-VJEÇARIT, THONË SE DËSHTUAN INSTITUCIONET** F.3

### EKONOMI

**KOSOVA VAZHDON TË KETË BORXH PUBLIK TË ULËT** F.9

**270 PUNËKËRKUES PËRFITOJNË NGA PROGRAMET AKTIVE TË TREGUT TË PUNËS** F.8

### SPORT



**REAL - LIVERPOOL, BETEJA PËR MBRET TË EVROPËS** F.18

**SEJDIU BRAKTIS VËLLAZNIMIN PARA FINALES SË KUPËS** F.18



## Opozita kërkon zgjedhje të reja, pozita konsensus për tema të tjera

Edhe tryeza e tretë me radhë e partive politike nuk ka sjellë ndonjë rezultat pozitiv rreth gjetjes së një konsensusi për temat e mëdha që e presin vendin. Lëvizja Vetëvendosje,

e cila e kishte thirrur këtë tryezë të premten, ka kërkuar zgjedhje të reja kombëtare. Këtë kërkesë e ka përkrahur edhe LDK-ja. Ndërsa partnerët e koalicionit qeverisës

kanë kundërshtuar idenë për zgjedhje të reja, duke thënë se vendi ka nevojë për konsensus kombëtar për disa tema, dhe jo për zgjedhje të reja

## Bëhen përgatitjet për testin e maturës në rajonin e Gjilanit dhe të Ferizajt



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Curëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**SatStyro**  
Mushnikovë-Prizren-Kosovë  
Product of EPS and XPS  
Mob.: +377(0) 44 506 815  
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030  
e-mail: [sat\\_styro@yahoo.com](mailto:sat_styro@yahoo.com)  
[www.satstyro.com](http://www.satstyro.com)

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666



## Vuçiqi: Perëndimi po e mbështet Kosovën e pavarur

**BEOGRAD, 25 MAJ** - "Është e qartë se Perëndimi po e mbështet pavarësinë e Kosovës, kjo është e ditur, por ne po përpiqemi ta mbrojmë popullin tonë atje, nuk presim shumë, por do të

jetë e vështirë", tha Vuçiqi. Kryetari i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, duke komentuar deklaratën e Avni Arifit, koordinatori i ekipit të Kosovës për dialog në mes të Kosovës e Serbisë,

lidhur me AKS-në, deklaroi se "meqë Prishtina zyrtare nuk po i realizon marrëveshjet e arrira në Bruksel, ne duhet të mësohemi të jetojmë në standarde të dyfishta dhe të mos presim për


më mirë, por që do të jetë vërtet vështirë", njoftojnë mediet serbe. "E shihni se askush nga ndërkombëtarët nuk kanë reaguar ndaj deklaratave të Avni Arifit", tha Vuçiqi.



Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, është takuar në Tiranë me presidentin shqiptar, Ilir Meta

## Veseli: Kosova dhe Shqipëria po ecin sigurt drejt BE-së

Kryeparlamentari Kadri Veseli tha në Tiranë se Kosova dhe Shqipëria tashmë e kanë të qartë aspiratën dhe rrugën të cilën duhet ndjekur për ta arritur synimin e përbashkët - integrimin euroatlantik, duke shtuar se Kosova është në pritje të hapit vendimtar të BE-së për t'i liberalizuar vizat për qytetarët e Kosovës



**PRISHTINË, 25 MAJ** - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, vizitën e tij në Shqipëri e ka nisur me takimin me presidentin e Republikës, Ilir Meta. Kryeparlamentari Veseli dhe presidenti Meta diskutuan gjerësisht për marrëdhëniet midis dy shteteve, tashmë të konsoliduara në çdo fushë, me përkushtimin e përbashkët për t'i thelluar më tej.

Kreu i Kuvendit të Kosovës potencoi edhe një herë rolin crucial të Shqipërisë si në fazën e luftës dhe të shtetkrijimit, po ashtu edhe të konsolidimit të shtetësisë dhe forcimit të subjektivitetit ndërkombëtar të saj. Veseli tha se Kosova dhe Shqipëria tashmë e kanë të qartë

aspiratën dhe rrugën të cilën duhet ndjekur për ta arritur synimin e përbashkët - integrimin euroatlantik.

Kryetari i Kuvendit tha se Kosova është në pritje të hapit vendimtar të Bashkimit Evropian për t'i liberalizuar vizat për qytetarët e Kosovës, si një e drejtë e merituar e tyre dhe e shtetit të Kosovës.

Presidenti Ilir Meta, nga ana e tij, përgëzoi kryeparlamentarin Veseli për vendimet kohët e fundit të Kuvendit të Kosovës, të cilat, sipas tij, i kanë hapur mundësi të reja shtetit të Kosovës në raport me Bashkimin Evropian.

Meta tha se Shqipëria vazhdon të mbetet në krah të Kosovës në të gjitha sfidat që ajo ka para vetes

dhe se i gëzohet çdo arritjeje të saj si në planin e brendshëm, po ashtu edhe në rrafshin ndërkombëtar.

### Veseli takon homologun Gramoz Ruçi

Kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, po të premten është takuar edhe me kryetarin e Kuvendit të

Shqipërisë, Gramoz Ruçi. Në këtë takim të ngrohtë e miqësor, të dy kryeparlamentarët diskutuan për zhvillimet e fundit në të dy vendet, në jetën parlamentare në Kosovë e Shqipëri, si dhe për shtrirjen e mëtejme të bashkëpunimit midis dy vendeve dhe parlamenteve respektive.

Kryetari Veseli e njoftoi kreun e Kuvendit të Shqipërisë me

angazhimet e legjislativit të Kosovës për përmbushjen e detyrave të tij kushtetuese, sidomos për përkushtimin për të çuar përpara agjendën evropiane të vendit.

Kryeparlamentari Ruçi u shpreh i nderuar ta presë në takim homologun nga Kosova, duke u shprehur i kënaqur me arritjet e Kosovës në shumë sfera.

## Opozita shqiptare proteston kundër Qeverisë



**TIRANË, 25 MAJ** - Sot (e shtunë) opozita shqiptare organizon protestë kundër Qeverisë, ku protestuesit do të mblidhen në orën 11.00 në krye të Bulevardit të "Dëshmorët e Kombit", sipas një vendimi të fundit që u mor në takim me aleatët opozitarë në zyrën e kreut demokrat. Kjo do të jetë një protestë me kohëzgjatje normale dhe drejtues të Partisë Demokratike kanë kontaktuar me drejtues të policisë në mënyrë që qytetarët të mos pengohen t'i bashkohen asaj. Vetë konceptimi i

protestës si marshim i jep asaj një natyrë tjetër nga ajo e 27 janarit, ku u protestua kundër kapjes së drejtësisë nga qeveria pas zgjedhjes nga mazhoranca të Arta Markut kryeprokurore e përgjithshme e përkohshme. Nëse ajo e janarit u organizua për 1 muaj, kjo e 4 muajve më pas bëhet një javë nga thirrja e Lulzim Bashës.

Sot (e shtunë) do të ketë demonstrime simbolike ku pritet të gjejë shprehje i gjithë aktualiteti i më shumë se dy javëve me akuzat e

Partisë Demokratike se ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj, ka garantuar paprekshmëri për vëllanë e tij të dënuar me mbi shtatë vjet burg për trafik ndërkombëtar droge.

Protesta e opozitës ndodh ndërsa Tirana po vizitohet nga zyrtarë të vendeve dhe organizatave ndërkombëtare. Gjermani Florian Hahn u largua nga Shqipëria, ndërsa takime të nivelit të lartë po zhvillon kreu i asamblesë parlamentare dhe sekretari i përgjithshëm i OSBE-së.

## Donald Lu largohet nga Shqipëria

**TIRANË, 25 MAJ** - Ambasadori i ShBA-së, Donald Lu, pritet të largohet në korrik nga Shqipëria dhe ai do ta nisë misionin e ri në Lindje, Kirgistan. Të premten Shtëpia e Bardhë ka dërguar emrin e Donald Lusë për miratim në Senat si ambasador i ShBA-së në

Kirgistan. Pas propozimit emri i tij pritet ta marrë miratimin e Senatit për ta përfaqësuar Amerikën në ish-Republikën Sovjetike. "Donald Lu, Kaliforni, anëtar i Karrierës i Shërbimit të Lartë të Jashtëm, të emërohet ambasadori Fuqplotë i Shteteve të Bashkuara të Amerikës

në Republikën e Kirgistanit", thuhet në njoftimin e Shtëpisë së Bardhë.

Kirgistani është tejet malor, me 5.5 milionë banorë. Kirgistani është një vend ku ndikimi rus konsiderohet i madh përshkak edhe të një minoriteti rus që është pjesë e

këtij shteti. Emërimi i Donald Lusë në Kirgistan është një rikonfirmim në pozitën e tij si ambasador. Paraardhësit e Donald Lusë në këtë detyrë në Shqipëri, pas mbarimit të misionit, janë transferuar në detyra të tjera në Departamentin e Shtetit, por



shumë pak prej tyre kanë marrë sërish emërimin ambasador në ndonjë vend tjetër.



Mbahet tryeza e radhës e partive politike

# Opozita kërkon zgjedhje të reja, pozita konsensus për tema të tjera

Edhe tryeza e tretë me radhë e partive politike nuk ka sjellë ndonjë rezultat pozitiv rreth gjetjes së një konsensusi për temat e mëdha që e presin vendin. Lëvizja Vetëvendosje, e cila e kishte thirrur këtë tryezë të premtën, ka kërkuar zgjedhje të reja kombëtare. Këtë kërkesë e ka përkrahur edhe LDK-ja. Ndërsa partnerët e koalicionit qeverisës kanë kundërshtuar idenë për zgjedhje të reja, duke thënë se vendi ka nevojë për konsensus kombëtar, për disa tema dhe jo për zgjedhje të reja

gjerë", ka deklaruar Krasniqi. Edhe sekretari i përgjithshëm i AAK-së, Blerim Kuçi, ka vlerësuar se zgjedhjet nuk janë në interes të përbashkët kombëtar. "Sa iu përket zgjedhjeve edhe në takimin e parë kemi folur se nuk ka kuptim të kërkohen zgjedhje të parakohshme. Nuk është temë më konsensusi kombëtar. Z. Kurti tha se ka një tendencë që tryezat e tilla ta zëvendësojnë Kuvendin. Pikërisht kjo tryezë, kjo temë e zëvendëson Kuvendin. Kur opozita i ka votat, atëherë kjo

çështje duhet të shkojë në Kuvend dhe të kërkohet mocioni i mosbesimit të Qeverisë, atëherë nëse i keni 61 vota, bie kjo Qeveri", ka thënë Kuçi. Ndërsa nënkryetari i PSD-së, Dukagjin Gorani, ka thënë se nuk mund të kërkohet shkuarja në zgjedhje nëse duhet të vazhdohet procesi i dialogut Kosovë - Serbi. "Sot duket se dy fjalët kryesore janë prioriteti dhe konsensusi. Prej asaj që po hetohet, shihet se ekzistojnë dy prioritete të mëdha politike në vend të cilat përfshij-

tojnë njëra-tjetrën. Pra, procesi i dialogut dhe domosdoshmëria e zgjedhjeve. Nëse duhet të vazhdohet dialogu, atëherë nuk mund të shkohet në zgjedhje. Nëse duhet të shkohet në zgjedhje do të jetë e pamundshme të rifillohet dialogu", ka theksuar Gorani.

Në fund të tryezës, Lëvizja Vetëvendosje ka prezantuar një deklaratë, e cila është nënshkruar edhe nga tri subjekte të tjera politike. Përmes kësaj deklaratë opozita e fton kryeministrin Haradinaj ta masë veten në Kuvend dhe të shikojë nëse e ka shumicën. "Ne, subjektet politike të Republikës së Kosovës, pajtohemi që në situatën aktuale rruga e duhur për një qeverisje legjitime dhe demokratike janë zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të organizuara në kohën më të përshtatshme të mundshme por, pa vonesa. Kryeministri nuk mund ta vijojë qeverisjen dhe marrjen e vendimeve më tej, pa provuar në Kuvend shumicën. Andaj e ftojmë kryeministrin dhe Qeverinë të votëbesohet dhe të dëshmojë në Kuvend se mund të Qeverisë", është thënë në deklaratën e tryezës së Lëvizjes Vetëvendosje dhe të tri partive të tjera.

**EPOKA  
ERE****Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 25 MAJ** - As tryeza e tretë me radhë e partive politike nuk ka sjellë ndonjë konsensus kombëtar ndërmjet subjekteve politike për temat e mëdha që e presin vendin. Në tryezën e organizuar nga Lëvizja Vetëvendosje të premtën, opozita ka kërkuar zgjedhje të parakohshme parlamentare, kurse pozita është shprehur kundër zgjedhjeve të reja, duke thënë se ato janë të panevojshme.

Nikoqiri i kësaj tryeze, lideri i LV-së, Albin Kurti, ka thënë se kryeministri Haradinaj duhet të japë dorëheqje pasi në krye të Qeverisë ai ka bërë vetëm veprime të dëmshme. Sipas Kurtit, Haradinaj është një kryeministër i pakicës dhe se duhet të dorëhiqet ose ta masë veten në Kuvend. "Kryeministri Haradinaj duhet të japë dorëheqje dhe vendi të shkojë në zgjedhje të lira dhe demokratike. Këto të zeza që na i bëri Haradinaj nuk ua ka premtuar qytetarëve para një viti. Le të shkojmë në zgjedhje dhe atëherë qytetarëve të Rugovës le t'ua hedhë hartën për fytyrë, siç ia hodhi Murat Mehës. Kush mund të ketë besim në kryeministrin Haradinaj? Dikur e mbante bajrakun për demarkacionin, kurse sapo u bë kryeministër e ndërroi qëndrimin", ka deklaruar Kurti.

Edhe nënkryetari i LDK-së, Agim Veliu, ka thënë se vendi është në një krizë institucionale pasi nuk ka funksionim të mirëfilltë të Qeverisë dhe as të Kuvendit. "Duke pasur parasysh se vendi po kalon nëpër procese të rëndësishme, ne si LDK kemi dashur t'i japim përparësi arritjes së një konsensusi të subjekteve politike për një periudhë të caktuar

kohore për mbajtjen e zgjedhjeve. Në vazhdimin e këtyre tryezave është mirë të arrihet konsensusi se kur do të jetë data e zgjedhjeve", ka thënë Veliu. Mirëpo subjekti më i madh i koalicionit qeverisës, PDK-ja, i ka kundërshtuar zgjedhjet e reja. Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se opozita është në krizë dhe jo pozita. "Tema e sotme realisht është farsë, sepse as nuk ka guxim e as interes për zgjedhje. Mbi të gjitha, mua më vjen keq që është kidnapuar ideja e tryezave duke folur për zgjedhjet sot, në vend se ne me të vërtetë të diskutonim për një prej temave që ne jemi pajtuar që duhet t'i diskutojmë seriozisht, tentimin për ta arritur një konsensus më të

## Haradinaj: Unë po i kryej detyrat, Kurti është i papunë

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, i është përgjigjur kërkesës së kryetarit të Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurtit, për dorëheqje. Haradinaj ka thënë se ai është duke punuar ashtu siç ia përcaktojnë Ligji dhe Kushtetuta e vendit. Në raport me kërkesën e Albin Kurtit për të dhënë dorëheqje, Haradinaj ka thënë se Kurti është paksa i papunë dhe ka kohë të bëjë kërkesa të tilla. "Tani ai është pak si i papunë, do të thotë duhet t'i riparojë dëmet që i kanë ndodhur me ndarjet në parti. E kuptoj, sepse kam kaluar nëpër temat në të cilat po kalon ai. S'kam çfarë t'i them më shumë. Po i kryej detyrat që m'i ka caktuar Kuvendi dhe Kushtetuta e vendit", ka deklaruar Haradinaj.



## Deputetët dënojnë vdekjen e 14-vjeçarit, thonë se dështuan institucionet

**PRISHTINË, 25 MAJ** - Anëtarët e Komisionit për të Drejtat e Njeriut kanë reaguar lidhur me rastin e 14-vjeçarit nga Kamenica, i cili vdiq si pasojë e dhunës së ushtruar nga babai i tij. Ky komision vlerëson se mekanizmat

shtetërorë nuk janë në nivelin e duhur sa i përket trajtimit të personave me probleme mendore. "Rasti në fjalë është edhe një tregues se shumë mekanizma institucionale nuk janë në nivel të detyrave dhe përgjegjësi,

për trajtimin adekuat dhe profesional të personave me të meta të çfarëdo natyre, që paraqet një burim potencial të dhunës në familje", është thënë në reagimin e Komisionit për të Drejtat e Njeriut.

Komisioni ka kërkuar nga institucionet kompetente dhe ato të specializuara të sigurojnë kushte dhe standarde të caktuara për trajtimin, mbikëqyrjen dhe izolimin e personave potencialisht të mundshëm për shkaktimin e

çdo lloj dhune në familje dhe në shoqëri. Rasti i rëndë në Kamenicë ndodhi para dy ditësh dhe motivi i rrahjes që babai i bëri djalit të tij kishte të bënte me faktin se i riu kishte shpenzuar një shumë parash pa dijeninë e prindit.




Flet për "Epokën e re", Shkëlzen Maliqi

# S'ka kohë për të eksperimentu

**- Ideja për zëvendësimin e presidentit Thaçi nuk motivohet që dialogu të përfundojë me sukses, por që ai të rrënohet**

Analisti politik Shkëlzen Maliqi ka vlerësuar se opozita nuk është unike dhe nuk ka disponim për ngritjen e mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë. Ai ka thënë se disa parti nuk janë të gatshme për zgjedhje dhe se shumicës u konvenon një qeveri e "mekët", as mish as peshk. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Maliqi ka theksuar se presidenti Thaçi nuk është figurë e pazëvendësueshme në dialogun me Serbinë por, sipas tij, nuk ka kohë të eksperimentohet dhe të shkaktohen vonesa në këtë proces. Maliqi ka vlerësuar se ideja për zëvendësimin e Thaçit nuk motivohet që dialogu të përfundojë me sukses, por që ai të rrënohet. Sipas tij, nëse partitë mbesin të përçara rreth dialogut, do të ketë vonesa të panevojshme dhe Kosova do të dalë joserioze karshi pritjeve të faktorëve ndërkombëtarë



**EPOKA E RE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 25 MAJ -

**"Epoka e re":** Z. Maliqi, çfarë vlerësimi keni për qeverisjen e koalicionit PAN dhe për rolin e opozitës?

**Maliqi:** E kemi një Qeveri që as energjia dhe vendosmëria e Ramush Haradinajt, një leadership prej komandanti militant me të cilën ai krenohej, nuk po funksionon. Qeveria përbëhet prej shumë subjekteve dhe individëve me interesa të veçanta, kështu që ndonjëherë krijohet përshtypja sikur dora e majtë e Qeverisë nuk di çfarë është duke e bërë dora e djathtë e saj. Po ashtu, ajo është e madhe dhe me një batalion ministrash e zëvendësministrash që vështirë koordinohen mes vete. Punën e Qeverisë e vështirëson edhe diçka: ajo nga fillimi nuk ka pasur program të qartë, pos zgjidhjes së çështjeve urgjente që i shtroheshin nga mostrajtimi i tyre i duhur nga Qeveria e mëparshme, ose për realizmin e atyre detyrimeve që Kosovës i shtroheshin nga jashtë. Në disa ndërmarrje të saj "energji" dhe me urdhër të prerë, si puna e bordeve dhe komisioneve, më shumë janë bërë dëme se avancime.

**"Epoka e re":** Aktualisht koalicioni nuk e ka shumicën dhe kjo shpeshherë po e vë në pikëpyetje funksionimin e Kuvendit, por as opozita nuk po duket se ka disponim për të

ngritur mocion ndaj Qeverisë. Ka kapacitete opozita për ta rrëzuar këtë Qeveri?

**Maliqi:** Po, ky është edhe një aspekt tjetër shumë i rëndësishëm që kushtëzon pabëzimin e komandantit të Qeverisë, sepse vërtet nuk është e qartë a është Qeveria e mbështetur nga numrat e duhur të deputetëve, apo jo. Lista Serbe pati dalë nga Qeveria zhurmshëm, por në të vërtetë edhe më tej sillet sikur është pjesë e saj, se do të kthehet dhe ta votojë atë në rast se vihet para testit të votëbesimit. Sikur shumicës i konvenon ta kemi një Qeveri të tillë të 'mekët', as mish as peshk. Nga ana tjetër, siç e konstatuat dhe ju, opozita nuk është unike dhe nuk ka disponim për mocion të mosbesimit, sepse disa parti nuk janë të gatshme që në këtë moment të dalin në zgjedhje. Çarja e Lëvizjes Vetëvendosje ka shkaktuar tretjen e idesë se 'i kemi numrat e deputetëve shqiptarë' nga viti 2014, me të cilën Albin Kurti kishte iniciuar krijimin e koalicionit të parë të gjerë VLAN, i cili, derisa ishte aktiv, edhe më pas kur u prish, shkaktoi ngecjen dhe vendnumërimin trevjeçar të Kosovës. Grupi që doli nga Vetëvendosja zgjodhi një rrugë të shkurtuar të shndërrimit në parti duke u veshur me petkun e Partisë Socialdemokrate të Kosovës, e cila ishte pothuajse praktikisht inekzistente, por tani mori një infuzion të fuqishëm me 12 deputetë të

Kuvendit, duke u bërë forcë e katërt në skenën politike. PSD-ja e rinovuar, megjithatë, tregohet e kujdesshme që të mos shkohet në zgjedhje menjëherë, por i duhet një periudhë e konsolidimit të saj në terren për t'i bindur votuesit potencialë të saj, se është një

alternativë serioze për Lëvizjen Vetëvendosje dhe partitë e tjera.

**"Epoka e re":** Ç'rezultat prisni nga tryezat e partive politike?

**Maliqi:** Tryezat e partive kanë për qëllim të krijojnë një unitet mbase edhe të përkohshëm të skenës sonë politike para sfidës

së përfundimit të përsheptuar të dialogut me Serbinë. Presidenti Thaçi prej kohësh, kur është kërkuar që dialogu të zhvillohet në nivel të presidentëve, paralajmëronte krijimin e ekipit të unitetit, por kjo nismë e tij nuk pati sukses. Tani kjo çështje është bërë urgjente, sepse koha



# ar me dialogun Kosovë - Serbi

zëra që kundërshtojnë rolin kyç të Thaçit në dialog. Nëse partitë mbesin të përçara rreth kësaj sërish do të kemi vonesa të panevojshme dhe të dalim si palë joserioze karshi pritjeve të faktorëve ndërkombëtarë, të cilët përfundimin e shpejtë të dialogut nuk e kërkojnë pa arsye të fortë. Ata janë insistues për këtë, nga frika se rajoni mund të bjerë nën ndikimin e Ruisë, e cila provokon trazira në Ballkan, me synimin që ta dobësojë BE-në.

**"Epoka e re":** Këto tryeza thuhet se janë iniciuar me qëllimin e vetëm, për të shkuar në zgjedhje të parakohshme. A po shihni klimë për zgjedhje të reja?

**Maliqi:** Tryezat nuk janë instrument që çojnë në zgjedhje, sepse për zgjedhje do të mjaftonte nëse partitë opozitare do të arrinin konsensus mes vete dhe t'i siguronin numrat e mjaftueshëm për mocionin që rrëzon Qeverinë dhe i bën zgjedhjet të pashmangshme. Nëse opozita nuk i ka numrat, janë të kota tryezat.

**"Epoka e re":** Është paralajmëruar faza finale e dialogut me Serbinë. Si e shihni përfundimin e këtij procesi? Opozita po kërkon që presidenti i vendit të mos jetë udhëheqës i këtij dialogu. Kush mund ta zëvendësojë Thaçin?

**Maliqi:** Përfundimi i dialogut,

nga ajo që është bërë publike nga deklaratimet e aktorëve të mëdhenj, nuk do të duhej të ishte i dëmshëm për Kosovën. Nëse dokumenti final dhe i obligueshëm parasheh njohjen e ndërsjellë, tërësinë e territorit të Kosovës (nuk ka ndarje ose shkëmbime terriroresh që kërkon Serbia!) dhe epilogu çon drejt anëtarësimit të Kosovës në OKB, nuk e shoh se cili do të mund të ishte kompromisi i dëmshëm për vendin tonë dhe nëse do të ketë kompromise, mendoj se ato do të janë gjithsesi dytësore, jo esenciale. Sa i përket karakterit dhe drejtimit të dialogut, mendoj se qëllimi i opozitës, sidomos i Lëvizjes Vetëvendosje, është pengimi ose ndryshimi i formatit të dialogut, sidomos pengimi i ambicies së presidentit Thaçi që ai ta përfundojë procesin të cilin e ka filluar dhe udhëhequr deri më tani. Mendoj se ky synim i LV-së, dhe atyre që e përkrahin, është i rrezikshëm sepse vazhdon me logjikën e politikave të prapakthimeve që e ka karakterizuar ideologun kryesor të LV-së, Albin Kurtin, kur e kundërshtonte Marrëveshjen e Rambujesë, Planin e Ahtisarit, formatin e shpalljes së pavarësisë, në mënyrë të vazhdueshme i thoshte jo dialogut me Serbinë etj., duke mos e pranuar asnjëherë se i gjithë ky proces nuk na ka çuar prapa në

sundim të Serbisë, siç predikohej, por përpara, në fuqizimin e shtetësisë dhe mëvetësisë së Kosovës. Kuptohet, nuk mendoj se Thaçi është figurë e pazëvendësueshme, por proceset kanë avancuar shumë dhe formati i bisedave tashmë është në fazën e tillë, ku nuk kemi kohë të eksperimentojmë dhe të shkaktojmë vonesa të reja në procesin e dialogut. Gjithsesi, pasi që edhe vetë presidenti ka kërkuar që dialogu të vazhdohet me një ekip të unitetit, mendoj se ai do të duhej ta reflektonte pozitën e vet, që ai mos të jetë vendimmarrësi i vetëm në finalen e procesit, por të krijojë një instrument shtesë ndërmjetësues për vendimmarrje, ku për propozimet e kompromiseve eventuale të reja, ta ketë afër vetes në grup të liderëve partiakë dhe institucionalë, nëse jo nga të gjithë subjektet relevante politike, atëherë nga shumica e tyre. Shikoni, kur procesi i dialogut është në fazën në të cilën aktualisht nuk është aspak praktike dhe e mençur që të kërkohej transparenca maksimale e propozimeve kompromise, duke i çuar ato si të tilla në Kuvend ose në referendum. Kjo duhet të ndodhë më vonë si masë eventuale korrigjuese. Zakonisht, një procedim i tillë i transparencës hap shtigje për manipulime dhe dështimin e procesit. Ka dhe një mundësi. Presidenti nuk do ta dëmtonte

veten nëse do të tërhiqej nga procesi duke thënë: unë e sigurova që procesi të vijë deri te finalja dhe qenkam pengesa që dialogu të përfundojë me sukses. Po tërhiqem për të mirën e vendit. Vetëm se problem në këtë rast do të ishte kush do ta merrte stafetën për fundin e dialogut. Ideja për zëvendësimin e Thaçit, sipas meje, nuk motivohet që dialogu i deritashëm të përfundojë me sukses, por që ai të rrënohet dhe mohohet.

**"Epoka e re":** Z. Maliqi, tashmë Qeveria ka nisur procedurat për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Cili do të jetë epilogu i këtij procesi? Do të kemi asociacion me apo pa kompetenca ekzekutive?

**Maliqi:** Thashë dhe më parë, nuk duhet pritur kompromise të mëdha, duke pasur parasysh Asociacionin e Komunave me shumicë Serbe, si një detyrim që tashmë është vënë nën vijat e kuqe që pamundësojnë ngritjen e kompetencave ekzekutive dhe autonome të saj. Te kjo çështje ndoshta mund të jepen disa siguri shtesë, se formati i Asociacionit nuk do t'i dëmtojë interesat e veçanta të serbëve të Kosovës, por këto garanci do të duhej të ishin të dyanshme, që edhe Kosovës t'i garantohet se serbët nuk do të bëhen instrumente për ndërhyrjet e Serbisë në çështjet e Kosovës.

## Bëhen përgatitjet për testin e maturës në rajonin e Gjilanit dhe të Ferizajt

**EPOKA E RE**

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 25 MAJ - Këshilli Shtetëror i Maturës (KShM), i kryesuar nga kryetari Fehmi Hysenaj, ka mbajtur të premtën takimin e radhës për finalizimin e përgatitjeve për organizim të Maturës Shtetërore 2018, i cili fillon më 28 maj në rajonin e Gjilanit dhe të Ferizajt.

Kryetari Hysenaj ka marrë pjesë edhe në takimin me Kolegjin e Drejtorëve Komunal të Arsimit, ku temë qendrore ishte organizimi dhe mbarëvajtja e testit të maturës. Në të dyja këto takime u theksua nevoja për angazhim maksimal dhe respektim të vendimeve të MASHT-it sa iu përket detyrave dhe përgjegjësi që kanë të gjithë të angazhuarit në këtë proces, por edhe të nxënësve. Në mënyrë që ky proces të shkojë sipas planifikimeve,



ministri Bytyqi ka marrë disa vendime, sipas të cilave, parashihen masa ndëshkuese për ata që nuk i përfillin rregullat. Në bazë të këtyre vendimeve askush nuk lejohet të hyjë në klasë me celularë, përfshirë këtu edhe administratorët, ndërsa komisionarët janë personat kryesorë përgjegjës për qendrat e testimit, kurse nga një mbikëqyrës do të

caktohet për pesë administratorë. Përveç celularëve, nuk lejohet asnjë lloj materiali tjetër që mund të jetë burim i të dhënave lidhur me përmbajtjen e testit. Ndërsa kushdo që nuk i respekton rregullat, fillimisht largohet nga procesi i administrimit (administruesit), apo nga testimi (nxënësit), pastaj ndaj të njëjtëve do të merren masa adekuate në përputhje të

rregullave dhe akteve ligjore administrative.

Për dallim nga vitet e tjera, sivjet testi i maturës organizohet për katër ditë me radhë (pjesa e parë) dhe katër ditë pjesa e dytë, të ndara në rajone, ku radha është përcaktuar me short publik, ndërsa pyetësori do të jetë i ndryshëm secilën ditë, me ekuivalencë të njëjtë të vlerësimit.

po rrjedhë shpejt dhe duhet të sqarohet edhe me opozitën atë që Haradinaj dhe Thaçi janë marrë vesh, që presidenti ta udhëheqë përfundimin e dialogut. Kjo nuk i pëlqen LV-së, mbase edhe një pjesë të LDK-së, ndërkaq që edhe tek Nisma Socialdemokrate po kështu ka



## Cakolli: Jemi të përkushtuar për avancimin e mbrojtjes nga sulmet kibernetike

EPOKA E RE  
Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 25 MAJ - Zëvendësministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Bujar Cakolli, ka marrë pjesë në konferencën me temë "Infrastrukturat kritike të informacionit dhe mbrojtja e tyre - CIIP & GDPR", e cila është organizuar në kuadër të Kolegjit të Biznesit dhe Teknologjisë (UBT).

Cakolli ka thënë se Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë

është përkushtuar të angazhohet në këtë fushë. "Ne si ministri e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, edhe si shoqëri, jemi të vetëdijshëm për zhvillimet teknologjike sikurse për sfidat me të cilat ballafaqohemi nga evolimi dinamik i saj. Duhet falënderuar Kolegjin e Biznesit dhe Teknologjisë si një entitet i cili në vazhdimësi angazhohet të jetë në trend me zhvillimet dhe përfitimet që t'i sjellë shoqërisë së Kosovës aktivitete për mbrojtjen e të dhënave dhe privatësinë e

qytetarëve si një domen tejet sensitiv, për çfarë Qeveria e Kosovës, me theks të veçantë Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, mbetet e përkushtuar ta pozicionojë në vendin dhe mënyrën e duhur", ka thënë zëvendësministri Cakolli. Ai ka shtuar se Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë e shih si partnere UBT-në dhe të gjitha institucionet e tjera akademike që kanë kompetencë dhe ekspertizë profesionale për mbrojtje nga sulmet kibernetike.



## Kosova hapi Konsullatën e Nderit në Nessebar-Burgas

PRISHTINË, 25 MAJ - Në kuadër të shtrirjes së përfaqësimit diplomatik, Republika e Kosovës për herë të parë që nga hapja e misionit diplomatik të Kosovës në Republikën e Bullgarisë ka përfunduar konsullatën e nderit në qytetin antik në Nessebar, në rajonin Burgasit, një vend turistik i mbrojtur nga UNESCO-ja në brigjet e Detit të Zi.

Në ceremoninë e hapjes së Konsullatës së Nderit në Nessebar, ambasadori Shpend Kallaba ka thënë se kjo konsul-

latë do të jetë një adresë më tepër për të gjithë ata shkencëtarë, afaristë, sportistë të rajonit të Detit të Zi, të cilët janë të interesuar për bashkëpunim kulturor, ekonomik, dhe tregtar ndërmjet dy vendeve.

Ndërkaq, pas marrjes së detyrës së Konsullit të Nderit, Plamen Kopchev ka thënë se është i nderuar që të jetë bullgari i parë Konsull Nderi i Republikës së Kosovës. "Para meje është një sfidë e madhe për të kryer me përgjegjësi dhe përkushtim këtë

mision. Jam i bindur se Konsullata e Nderit e Republikës së Kosovës këtu në Nessebar do të jetë një vlerë shtesë në marrëdhëniet në mes dy vendeve tona mike", ka theksuar Kopchev.

Qyteti antik i Nessebarit daton në listën e mbrojtjes së UNESCO-s që nga viti 1984, si dhe vizitohet gjatë sezonit veror nga 40 000 turistë brenda ditës, duke mbajtur primatin si destinacion kulturor e historik në Bullgari dhe më gjerë.



## Komandanti i FSK-së, pjesë e takimit të shefave të mbrojtjes në Gjermani

PRISHTINË, 25 MAJ - Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjeneralletenat Rrahman Rama, ka marrë pjesë në takim vjetor të shefave të mbrojtjes në Wiesbaden të Gjermanisë. Në këtë konferencë kanë marrë pjesë shefat e mbrojtjes të vendeve anëtare të NATO-s dhe të shteteve partnere. Konferenca vjetore e shefave të mbrojtjes, e cila është organizuar nga Komanda e Ushtrisë Amerikane për Evropë, kishte

për tematikë luftën kundër organizatave ekstremiste të dhunshme. Në njërin prej seancave të konferencës ka folur edhe komandanti i FSK-së, gjeneral Rrahman Rama, i cili është fokusuar në qasjen gjithëpërfshirëse të Kosovës në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm, progresin e saj për parandalimin e këtij fenomeni si dhe për vendosjen e një baze ligjore të aplikueshme që rregullon çështjen e pjesëmarrjes së

shtetasve të Kosovës në luftërat e huaja.

Gjeneral Rama gjatë qëndrimit në Wiesbaden u takua edhe me gjeneralin Curtis M. Scaparrotti, të cilin e ka falënderuar për mbështetjen e vazhdueshme dhe përmbytjesore të cilën Komanda e Ushtrisë Amerikane për Evropë po e jep për mbështetjen për Republikën e Kosovës, për rajonin e Ballkanit në përgjithësi, veçanërisht për ngritjen profesionale të FSK-së.



## Kërkohet zbatimi i strategjisë kundër krimit të organizuar

PRISHTINË, 25 MAJ - Në Ministrinë e Punëve të Brendshme është mbajtur të premtën takimi i radhës i grupit ndërinstitucional për implementimin e strategjisë dhe planit të veprimit kundër krimit të organizuar.

Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, njëherësh koordinatorkombëtar kundër krimit të organizuar, Selami Shkodra, ka kërkuar nga të gjithë aktorët e përfshirë, që ta vazhdojnë imple-

mentimin e objektivave në kuadër të aktiviteteve të strategjisë kundër krimit të organizuar. "Përtej objektivave të kësaj strategjie duhet që të gjithë së bashku të vihem në lëvizje që të mos mbetemi peng i krimit të organizuar dhe korrupsionit, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në moszhvillimin e shoqërisë. Duhet të bashkohemi të gjitha për t'i arritur objektivat tona shtetërore", ka thënë zëvendës-

ministri Shkodra.

Të gjithë anëtarët e grupit raportuan për periudhën e kaluar, ku u vlerësua se janë realizuar shumica e objektivave. Gjithashtu, u bë me dije se ka pasur një numër të madh të arrestuarve, ngritje të kallëzimeve penale dhe dënime të personave të përfshirë në krim të organizuar. Po ashtu, janë mbajtur edhe shumë trajnime për ngritje të kapaciteteve të institucioneve të zbatimit të ligjit.







Pas kthimit nga Vatikani, kryeministri Ramush Haradinaj ka mbajtur konferencë për medie

## Haradinaj: Me Papën biseduam për njohjen e Kosovës nga Vatikani

Kryeministri Ramush Haradinaj, pas kthimit të vizitës nga Vatikani, ka treguar se ka kërkuar nga Papa Françesku njohjen e shtetit të Kosovës. Kryeministri ka bërë me dije se Papa Françeskut dhe kardinalit Pietro Parolin ua ka shpjeguar rëndësinë që ka për Kosovën njohja nga shteti i Vatikanit

bëhemi anëtar i Interpolit. Në këtë drejtim fiton më shumë siguri, më shumë garanci për jetë të qetë, më shumë mbrojtje nga çfarëdo krimi e rreziku. Njëkohësisht, me njohjen e Kosovës fitohet paqe e mirëfilltë dhe e qëndrueshme në Ballkan për të gjithë", ka thënë Haradinaj. Ai ka treguar edhe qëndrimin e Papës për popullin e Kosovës. "Pata mundësinë, përpos ta falënderoj për kujdesin, për respektin që shpreh për Kosovën, t'ia shpreh edhe këtë kërkesë të popullit të Kosovës, duke i thënë se populli i Kosovës e ka shpresën te ju, i ka sytë kah ju dhe pret prej jush. Ai, pasi mori kërkesën, u kthye dhe më tha: 'E kam në zemër popullin e Kosovës. E ndiej. Do të lutem për ju, do të lutem

personalisht për ju dhe për vendin tuaj'. Ai ka shumë shpresë se Kosova dhe populli i Kosovës do ta gjejnë vendin e vet, në vendin e popujve të lirë dhe në paqe", ka thënë kryeministri Haradinaj. Shefi i Qeverisë ka treguar edhe për dhuratën që ia ka dërguar Papës. "Njëkohësisht Atit të Shenjtë kam pasur mundësinë t'i tregoj për Kosovën. Dhe, për të kisha përgatitur me kohë një dhuratë, një dhuratë shumë të çmuar, një letërkërkesë për njohje, me një mbulesë të logos të dhjetëvjetorit të pavarësisë", ka vlerësuar Haradinaj. Kryeministri ka folur edhe për takimin me kardinalin Pietro Parolin. "I shoqëruar edhe me disa kolegë, kam pasur takim

pune me eminencën e tij, kardinalin Pietro Parolin, që është edhe sekretar i Vatikanit, në hierarkinë e Shtetit të Vatikanit. Ai është kryeministër në Vatikani. Në këtë takim pune që ka zgjatur më shumë se një orë, kemi biseduar për tema bilaterale Kosovë - Seli e Shenjtë", është shprehur Haradinaj, duke përmendur temat që ka diskutuar me këtë zyrtar të lartë të Vatikanit. "Kryesisht kanë dominuar tema e ndjenjës së mirë që Kosova ka për Selinë e Shenjtë, e vlerave që kemi në tolerancën ndërfaqetare, e respektit të ndërsjellë, e përkushtimit që e kemi si vend për paqen në rajon dhe për anëtarësim në BE dhe në organizata të tjera ndërkombëtare. Patjetër për njohjen e Kosovës nga Vatikani", ka thënë Haradinaj.

EPOKA  
ERE **Faton DERMAKU**

PRISHTINË, 25 MAJ - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije se njohja nga Vatikani ka qenë në fokus të bisedës me Papa Françeskun. Pas kthimit nga vizita në Vatikan, kryeministri Haradinaj ka deklaruar se i kashpjeguar Papës rëndësinë që ka për Kosovën

njohja nga Vatikani. "Kryesisht biseda kishte këtë qëllim, të marrjes së njohjes apo të kërimit të njohjes. Dua t'ju them se edhe unë kam bërë kujdesin më të madh që si Kosovë të shpjegojmë se çfarë fiton familja evropiane me Kosovën. Çfarë fiton BE-ja nëse na jepet liberalizimi i vizave. Pra, nuk fiton as krim, as rreziqe, as emigrantë, por vetëm shkëmbime. Çfarë fiton Bota nëse ne

## Ministri Gashi: Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës ofron siguri

Ministri i Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, ka qëndruar të premtën për vizitë në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari". Ai ka theksuar se Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës ofron siguri për udhëtarët

PRISHTINË, 25 MAJ - Ministri i Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, ka vizituar të premtën Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari", ku është pritur nga drejtori i aeroportit, Haldun Firat Kokturk. Gjatë kësaj vizite ministri Gashi dhe drejtori i ANP-së, Kokturk, kanë biseduar lidhur me gjendjen aktuale të sigurisë, punën dhe të arriturat në aeroportin "Adem Jashari". Me këtë rast, ministri Gashi u shpreh se aeroporti qëndron jashtëzakonisht mirë sa i përket sig-

urisë, duke vlerësuar krijimin e hapësirës për bashkëpunim, e cila ndihmon në koordinimin e veprimeve në mes të institucioneve të sigurisë dhe aeroportit. "Është shumë me rëndësi ofrimi i sigurisë, për arsye se për qytetarët që udhëtojnë duhet të mbizotërojë ndjenja e sigurisë, e cila e bën më të lehtë udhëtimin", ka thënë ministri Gashi. Ndërsa drejtori i aeroportit Haldun Kokturk i ka prezantuar ministrit Gashi projektet e planifikuara që do të zbatohen

të ardhmen në ANP. Ai ka thënë se ka një bashkëpunim shumë të mirë me institucionet e sigurisë dhe është i gatshëm për zbatimin e çfarëdo rekomandimi që i vjen nga MPB. Po ashtu, ministri Gashi ka vizituar edhe Agjencinë e Shërbimit të Navigimit Ajror, ku u njoh me rrjedhën e punëve që zhvillohen atje. Ai ka vlerësuar mekanizmat e kontrollit të cilët i bënë Ministria e Punëve të Brendshme përmes divizionit për Siguri të Aviacionit nga Departamenti për Siguri



Publike dhe theksoi se bashkëpunimi i mirë mes MPB-së dhe aeroportit do të vazhdojë edhe në të ardhmen.



# Guvernatori i BQK-së: Sektori bankar në Kosovë është stabil

Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, ka bërë me dije se sektori bankar në Kosovë është duke shënuar rritje dhe zhvillim. "Sektori bankar në Kosovë vazhdon të jetë i sigurt, i qëndrueshëm, stabil, likuid dhe mirë i kapitalizuar, me rritje të vazhdueshme", ka thënë Mehmeti gjatë takimit me Grupin Punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa

Mehmeti ka thënë se BQK-ja do të vazhdojë t'i kryejë detyrat e përcaktuara me ligj, duke u angazhuar që bashkërisht me institucionet e tjera të kontribuojë për zgjidhjen e funksionimit të institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare në Kosovë.

dhe rritje në pasuri 5.8 %. Po ashtu, kemi zvogëlim të theksuar të kredive joperformuese prej 2.9 % nga 4.3 % sa ishin në prill të vitit 2017", ka thënë guvernatori.

Ai ka shtuar se sektori bankar paraqet shtyllën kryesore për financimin e ekonomisë së vendit, me anë të financimit të bizneseve dhe ekonomive familjare. "Gjendja e kredive në sektorin bankar më datë 30. 4. 2018 është 2.55 miliardë euro. Sektori bankar në Kosovë vazhdon të jetë i sigurt, i qëndrueshëm, stabil, likuid dhe mirë i kapitalizuar, me rritje të vazhdueshme", ka thënë Mehmeti.

**EPOKA E RE** **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 25 MAJ** - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, të premten ka pritur në takim Grupin Punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa, me të cilin ka diskutuar rreth mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit

nr. 04/L-093 për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare në Kosovë.

Mehmeti ka thënë se korniza ligjore aktuale plotëson nevojat për operim dhe mbikëqyrje të bankave dhe institucioneve financiare. Ai ka theksuar se legjislacioni i BE-së është një proces dinamik i cili në vazhdimësi

përcillet me ndryshim/plotësime. "BQK-ja, me qëllim të plotësim/ndryshimit të Ligjit për Banka, IMF dhe IFJB ka themeluar grupin punues, i cili është përgjegjës për shqyrtimin e legjislacionit të BE-së dhe plotësimin e Ligjit aktual me legjislacionin e BE-së", është shprehur ai.

Në këtë takim guvernatori



## 'Hyundai' shpreh interesim të investojë në Kosovë

**PRISHTINË, 25 MAJ (ER)** - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Safet Gërxhaliu, ka pritur të premten në takim përfaqësuesit e konglomeratit korean "Hyundai" të udhëhequr në Junwon Song. Gërxhaliu ka theksuar rëndësinë e rritjes së bashkëpunimit reciprok ndërmjet Koresë dhe Kosovës në fushën e energjisë, minierave dhe teknologjisë informativë.

Përfaqësuesit e kompanisë "Hyundai" kanë theksuar nevojën e rritjes së bashkëpunimit ekonomik ndërmjet dy vendeve, si dhe kanë shprehur

interesim specifik për të investuar në projektet e rëndësishme infrastrukturore dhe energjetike, përfshirë ndërtimin e Termocentralit "Kosova e Re", si dhe rehabilitimin e Termocentralit "Kosova B". Nën organizimin e Odës Ekonomike të Kosovës shumë shpejt do të aranzhohen edhe misione tregtare për kompanitë e Kosovës në Korenë e Jugut dhe për kompanitë koreane në Kosovë, për t'i promovuar mundësitë për partneritet biznesor dhe bashkëinvestime në shumë projekte të rëndësishme.





# Kosova vazhdon të ketë borxh publik të ulët

Ministri i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, ka marrë pjesë në Dialogun Ekonomik dhe Financiar në mes të Bashkimit Evropian, vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë, në nivel politik, që është mbajtur në Bruksel. Në fund të dialogut pjesëmarrësit kanë miratuar konkluzionet për secilin vend, ku për Kosovën është konstatuar se vazhdon të ketë borxh publik të ulët



PRISHTINË, 25 MAJ (ER) - Me ftesë të Presidencës së Këshillit të Bashkimit Evropian, ministri i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, ka marrë pjesë në Dialogun Ekonomik dhe Financiar në mes të Bashkimit Evropian, vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë në nivel politik që është mbajtur në Bruksel. Fokusi i këtij dialogu ishte në temën "Forcimi i kornizës fiskale si kontribut në konvergencën ekonomike". Ministri Beqaj ka theksuar përkushtimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për të

ndjekur një strategji konservatore të politikës makroekonomike, duke synuar nivelet e ulëta të deficitit buxhetor dhe borxhit publik. "Objektivat e Kosovës janë: vazhdimi i investimeve kapitale, racionalizimi i shpenzimeve operative, përmirësimi i efektivitetit të subvencionimit, mobilizimi i të ardhurave përmes zgjerimit të bazës tatimore e jo rritjes së tatimeve, rritja e eksporteve, si dhe zhvillimi ekonomik i vendit", ka theksuar ministri Beqaj. Në fund të dialogut pjesëmarrësit kanë miratuar kon-

kluzionet për secilin vend. Në konkluzionet e përbashkëta për Kosovën thuhet se, "me gjithë koston më të lartë se parashikimi i skemës së pensioneve të veteranëve të sapo është futur, Kosova ka ruajtur qëndrueshmërinë e financave publike". Po ashtu, është konstatuar se

Kosova vazhdon të ketë borxh publik të ulët, si dhe parashikimet e vitit 2018 për të ardhura më të larta buxhetore mbështeten kryesisht në përmirësimet në mbledhjen e të ardhurave dhe rritjen e aktivitetit ekonomik. Kosovës iu rekomanduan

veprime në disa fusha të shoqëruar me masa në planifikimin makro-fiskal, në planifikimin e investimeve shumëvjeçare, për ta luftuar ekonominë informale, si dhe masa për plotësimin e futjes së skemës së sigurimeve të përgjithshme shëndetësore.

## 270 punëkërkuës përfitojnë nga programet aktive të tregut të punës

EPOKA  
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 25 MAJ - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në bashkëpunim me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), ka mbajtur të premtën ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjeve në mes të përfituesve të programeve aktive të tregut të punës, ku do të përfitojnë 270 punëkërkuës. Ministri i MPMS-së, Skender Reçica, me këtë rast ka përgëzuar të rinjtë që kanë përfituar nga ky program, duke shtuar se punësimi i të rinjve është prioritet kryesor i

MPMS-së. "Si MPMS po punojmë në shumë drejtime dhe në disa programe. Një nga pikat programore të Qeverisë është punësimi i një anëtarit të secilës familje që nuk e kanë asnjë të punësuar dhe në këtë drejtim po punojmë shumë që këtë pikë programore ta bëjmë realitet. Për këtë jam duke u angazhuar shumë edhe personalisht", ka thënë Reçica. Po ashtu, ai ka theksuar se, krahas masave aktive të tregut të punës, MPMS po angazhohet shumë edhe për arritjen e marrëveshjeve për punësim sezonal me disa vende të BE-së, duke premtuar se së shpejti do të kemi lajme të mira

në këtë drejtim. Reçica ka falënderuar punëdhënësit e sektorit privat për mundësinë që kanë ofruar, që përmes programit të subvencionimit në pagë dhe praktikës në punë, do të përfitojnë 270 persona. Ministri Reçica ka falënderuar edhe UNDP-në duke premtuar se MPMS-ja do të bashkëpunojë edhe në projekte të tjera në kuadër të masave aktive të tregut të punës. Ai ka thënë se shumë shpejt do të kenë edhe ftesën për programet e vetëpunësimit, e cila është një mundësi e re për të rinjtë dhe të rejtat që përmes ndërmarrësisë do të krijojnë vende punë për veten e

tyre, por edhe për të tjerët. Ndërkaq zëvendësperfaqësuesja e përhershme e UNDP-së në Kosovë, Alessandra Roccalvo, ka uruar të gjithë përfituesit e programit, duke thënë se përmes kësaj skeme UNDP-ja po synon të realizojë disa objektiva rreth punësimit. "Së pari të ofrojmë mundësi punësimi për punëkërkuësit e rinj të cilat kanë vështirësi të hyjnë në tregun e punës dhe t'i bëjnë hapat e duhur në karrierë, ndërsa objektivi i dytë është të ofrojmë mundësi për zhvillimin e bizneseve, duke mbështetur rritjen e numrit të të punësuarve, duke pasur parasysh

vështirësitë që ballafaqohen kompanitë private për angazhimin e stafit profesionist adekuat për aktivitetet biznesore", ka thënë Roccalvo. Ajo ka shtuar se brenda disa javësh do ta festojnë Ditën Botërore të Aftësive Rinore, ku shumë të rinj do të kenë një mundësi të mirë për zhvillimin e aftësive të tyre edukative dhe arsimore. Me këtë rast, Roccalvo ka falënderuar MPMS-në dhe Agjencinë e Punësimit për bashkëpunimin e mirë dhe, si rezultat i këtij partneriteti, këtë vit janë përzgjedhur 270 të rinj në skemën e subvencionimit në paga dhe praktikë në punë.



## Familjarët e dëshmorëve në Drenas pajtohen për zhvendosjen e varrezave

DRENAS, 25 MAJ (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, të premtën ka mbajtur takim me familjarë të dëshmorëve të kësaj komune, me të cilët ka diskutuar për zhvendosjen e varrezave të dëshmorëve në Polac në Kompleksin Memorial në Morinë të Skenderajt. Familjarët janë pajtuar të bëhet riarrosja e familjarëve të tyre dhe kjo është konfirmuar edhe

nëpërmjet nënshkrimeve të dhëna.

Komuna e Drenasit ka gjithsejtë 56 dëshmorë që do të riarrosen në Kompleksin e Dëshmorëve në Morinë. Rivarrimi i dëshmorëve të UÇK-së në Zonën Operative të Drenicës në varrezat e dëshmorëve në Kompleksin Memorial në Morinë është marrë me vendim nga kryeministri Ramush Haradinaj.



## Në qytetin e Mitrovicës shënohet Dita Olimpikë e Kosovës

MITROVICË, 25 MAJ (ER) - Rreth 300 filloristë nga disa shkolla të qytetit të Mitrovicës, të lindur në vitin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës, kanë marrë pjesë të premtën në aktivitetin e vrapimit që është mbajtur në shënim të Ditës Olimpikë të Kosovës.

Nënkryetari i Komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka, ka thënë se "sheshi i Mitrovicës është rrallëherë i bukur si sot, kur është i mbushur me fëmijë". Sipas tij, e veçanta e këtij manifestimi është se të gjithë garuesit e sotëm janë të lindur në vitin e

shpalljes së pavarësisë së Kosovës, për të cilët tha se janë e ardhmja e ndritshme e vendit. Në anën tjetër, vetë garuesja Edina Shala ka thënë se është jashtëzakonisht e lumtur që është lindur në vitin e pavarësisë së Kosovës.

## 'Prishtina lexon'

PRISHTINË, 25 maj (ER) - Komuna e Prishtinës, së bashku me 10 organizata joqeveritare, organizojnë Festivalin e Leximit "Prishtina lexon", i cili synon ngritjen e vetëdijes për rëndësinë e leximit tek nxënësit dhe e gjithë shoqëria.

"Prishtina lexon" ka filluar si festival i leximit që mbahet për Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve. Në edicionin e sivjetmë festa do të zgjasë shtatë ditë dhe përfshinë të gjitha moshat. Nën organizim marrin pjesë 10 organizata joqeveritare që merren kryesisht me lexim, dije, filozofi dhe aktivitete rinore.

Kjo është hera e parë që, krahas Komunës së Prishtinës, organizatat e shoqërisë civile e përbëjnë pjesën kryesore të programit, që fillon më 28 maj dhe përfundon më 3 qershor.

Në këtë edicion "Prishtina lexon" do të shtrihet në tërë Prishtinën dhe jo vetëm në sheshin kryesor. Aktivitetet e para do të mbahen të hënën



nëpër shkollat e Prishtinës, për nxënësit e klasave VI deri në IX nga organizata "Toka".

Aktiviteti i radhës, në po të

njëjtën ditë, është "Nata e letërsisë dhe poetikës", që do të mbahet në Bibliotekën "Hivzi Sylejmani" në orën 20:30.

## GIZ-i furnizon Skenderaj me 500 kontejnerë për mbeturina

SKENDERAJ, 25 MAJ (ER) - Komuna e Skenderajt, në kuadër të projektit "Shërbimet e qëndrueshme komunale", është furnizuar me 500 kontejnerë të madhësisë 120 dhe 100 litra. Kontejnerët për mbeturina janë donacion nga GIZ-i gjerman. "Ky donacion do t'i shërbejë Komunës së Skenderajt për një mjedis më të pastër. Falënderojmë GIZ-in për përkrahjen në fushën e menaxhimit të mbeturinave", është thënë në njoftimin e Komunës së Skenderajt. Ndërsa në vazhden e angazhimit për një ambient më të pastër, Komuna e Skenderajt të premtën ka bërë largimin e mbeturinave në Runik, tek ish-Shtëpia e Kulturës, iniciativë



kjo që ka filluar ditë më parë. Ish-Shtëpia e Kulturës ishte shndërruar në deponi ilegale për mbeturina, por tani është pastruar e tëra dhe është bërë edhe trasimi me zhavorr i hapësirës ku gjendet ky objekt.

## "Naim Frashëri" në Banjë shënon 90-vjetorin e themelimit

MALISHEVË, 25 MAJ (ER) - Shkolla Filllore e Mesme e Ulët (ShFMU) "Naim Frashëri" në Banjë ka shënuar 90-vjetorin e themelimit. Në këtë ngjarje edukative dhe arsimore morën pjesë kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, si dhe

ekipi i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim. Kjo shkollë me këtë rast bëri përrurimin edhe të muzeut që pasqyron vlerat historike nëpër periudha të ndryshme kohore të popullit shqiptar. Prerjen e shiritit e ka bërë kryetari i Komunës së

Malishevës, Ragip Begaj, bashkë me drejtorin e shkollës dhe ekipin e DAE-së. "Mjetet që sot i shohim në muze na rikujtojnë të kaluarën e prindërve tanë, veshjet autoktone të trevës sonë të punuara nga duart e nënave, librat me të cilët mësuam,

objektet e lashta, armët që fituam lirinë, prandaj ju përgëzoj për këtë punë madhore", ka thënë Begaj. Mësimdhënësit me nxënësit kishin përgatitur edhe një ekspozitë të artit figurativ, program të pasur kulturor-artistik.





In memoriam

# Emër përherë i respektuar në arsim e në shkencë

(Me rastin e katërvjetorit të ndarjes nga jeta të prof. dr. Adem Hajdaraj)

Në vitet më të stuhishme të shkollës shqipe, në vitet e '90, kur mbyllja e shkollave shqipe nga pushteti i dhunshëm serb tronditi botën demokratike, prof. Hajdaraj i priu arsimin shqip të Komunës së Pejës sipas strategjisë "shtëpitë-shkolla" nga posti i kryetarit të Shoqatës së Lidhje së Arsimitarëve Shqiptarë

**Hasan MUJAJ**

Vetëm fizikisht nuk është me ne, por rojnë me ne fjalët e tij mbresuese e yjzuese për arsimin, shkencën, gjuhën, artet, politikën, jetën private etj. Ishte e shtunë, 24 maj 2014, në orën e mësimin, me arsimtarët e programit AKM në Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Prizrenit, një shtrëngim gjoksi e detyroi ta lërë orën e mësimin para kohës. Të nesërmen, tok me kolegun Valdet Hysenaj, e vizitua në spital. Ishte mirë, i disponuar si përherë, zhvillua bisedë në stilin e kolegëve të ngushtë dhe në fund tha: "Sigurisht nesër do të dal". Na gëzoi. Ashtu ndodhi, por nuk doli i gjallë. E hënë, 26 maj. Pasdite. Kolegu Hysenaj më dha kumtin pikëllues, shumë pikëllues: "Na la profi!"

Jeta dhe veprimtaria e prof. dr. A. Hajdaraj shtrihet në tri fusha kryesore: arsimit, aktualiteti politik në Kosovë dhe studimet gjuhësore. Pjesën më të madhe të jetës ia kushtoi arsimin dhe edukimit. Ishte mes i viteve '60 kur prof. Hajdaraj filloi punën në Shkollën Filllore "Një maji" në fshatin Haxhaj të Rugovës; ishte arsimtar i gjuhës shqipe, i sapodiplomuar në ShLP të



Prizrenit. Më pas qe edhe drejtor i kësaj shkolle. Për generatat vijuese të anëve të Rugovës ishte inspirim me ndikim për arsimin e mësim, madje shërbente edhe si shembull referimi për ta ndjekur shkollimin në krahinën e Rugovës. Disa vjet mbolli shkëndijat e dritës e të diturisë të shumë gjenerata nxënësish edhe në Gjinnazin e Pejës, i dalluar si pedagog i përkryer dhe përherë i respektuar nga nxënësit, prindërit etj.

Në vitin 1976 u regjistrua në studimet pasuniversitare në Degën e Gjuhësisë Shqiptare të Universitetit të Prishtinës. Asokohe, në këtë nivel

studimesh, mbanin ligjërata profesorët zulumëdhënij dhe elitare të Universitetit të Tiranës, si: E. Çabej, Sh. Demiraj, M. Domi, J. Thomai etj. nga mori formim të gjerë lingvistik si themel i sigurt që të merrej me kompetencë me gjurmime të gjuhësisë shqiptare. U magjistrua në fushën e leksikografisë për të mbrojtur më vonë edhe disertacionin e doktoratës me titull "E folmja e Rugovës". Kontributi i prof. Hajdaraj është shumë i madh edhe në arsimin universitar: disa vjet punoi në ShLP të Prishtinës dhe më pas në Fakultetin e Edukimit si njëri nga katër profesorët e parë të themelimit të tij.

Qemë bashkudhëtarë mbi dyzet vjet: në studimet e magistraturës, të doktoratës, në shumë takime shkencore brenda dhe jashtë vendit, në konsulta profesionale e shkencore, në ligjërata studentësh, në komisione të Fakultetit, në kohën e lirë... etj. Në vitet më të stuhishme të shkollës shqipe, në vitet '90, kur mbyllja e shkollave shqipe nga pushteti serb tronditi botën demokratike, prof. Hajdaraj i priu arsimin shqip të komunës së Pejës sipas strategjisë "shtëpitë-shkolla" nga posti i kryetarit të shoqatës Lidhja e Arsimitarëve Shqiptarë. I dalë nga një familje me traditë

atdhetare dhe e ndjekur për veprimtarinë kombëtare, edhe prof. Hajdaraj qe i persekutuar dhe i sulmuar nga dhuna serbe. Ai ishte ndër veprimtarët e parë të masivizimit e të shtrirjes të një force të re politike që sapo kishte filluar të vegonte edhe në Kosovë në fillim të viteve të '90-ta. Qe edhe deputet i Kuvendit të Kosovës.

Kontributi i prof. Hajdaraj është shumë i çmueshëm edhe në studimet e gjuhës shqipe. Njësimin e gjuhës standarde shqipe e kishte parë me të drejtë si një nga arritjet më të mëdha të kulturës e të historisë kombëtare shqiptare. Që nga koha e studimeve e deri në orën e fundit të ligjërimit para studentëve, d. m. th. rreth një gjysmë shekulli, gjuhën shqipe e shpuri përpara në teori e në praktikë: foli e shkroi për të shumë kumtesa, trajtesa, polemika etj., të cilat synonte t'i bënte tok në botime të veçanta. Ndarja e papritur nga jeta ia ndërpreu veprimtarinë.

Prof. Hajdaraj voli me përkushtim të veçantë materie shumë të pasur leksikore në terren, në zonat malore të Rugovës dhe të krahinave të tjera shqiptare, atje tek bën jetë edhe sot një thesar i pasur e me vlerë për studimet e gjuhësisë shqiptare dhe për zhvillimin e saj.

Rëndësi të posaçme për studimin e mëtejshëm të dialektologjisë shqiptare dhe jo vetëm të saj, por edhe të shkencave të tjera të gjuhësisë, ka vepra e prof. Hajdaraj "E folmja e Rugovës", botim i Institutit Albanologjik të Prishtinës, e cila përmbledh në vete hulumtime dhe trajtime me kompetencë të lartë shkencore. Vepra pasqyron studimin më me vlerë nga të gjitha publikimet e derisotme për këtë të folme.

Me këtë veprimtari të pasur e të rëndësishme arsimore, edukative, shkencore, politike, kombëtare etj. prof. dr. Adem Hajdaraj do të mbetet emër me zulumë e kredibilitet prej intelektualit konceptiv me autonomi mendimi që prora e thoshte të vërtetën me gjithë rrjedhojat shpaguese.

## Një muaj paraburgim babait që mbyti 14-vjeçarin



GJILAN, 25 MAJ (ER) - Gjykata Themelore në Gjilan ka aprovuar kërkesën e Prokurorisë Themelore të kësaj komune, duke i caktuar masën e paraburgimit prej një muaji G. B. për vrasjen e djalit të vet 14-vjeçar. "I pandehuri G. B., shqiptar nga Komuna e

Kamenicës, dyshohet se më 24. 5. 2018, në mënyrë tejet të vrazhdë, me dashje, e ka privuar nga jeta djalin e vet, të ndjerin L. B., në atë mënyrë që të njëjtin e godet fillimisht me shufër plastike, pastaj me një shkop druri disa herë në pjesën e pasme të kokës e në pjesë të

tjera të trupit, duke mos i ofruar ndihmë, edhe pse kishte marrë plagë të rënda", është thënë në njoftimin e Gjykatës Themelore në Gjilan. Kjo gjykatë bën me dije se palët kanë të drejtën e ankesës ndaj këtij vendimi në Gjykatën e Apelit.



## Kryeministri spanjoll do të përballet me votëbesim

MADRID, 25 MAJ - Kryeministri i Spanjës, Mariano Rajoy, do të përballet me votëbesim në lidhje me rastet e korrupsionit që përfshijnë anëtarë të partisë së tij, Partisë Popullore. Kërkesa për votim për besimin e

Qeverisë u parashtrua nga socialistët e opozitës, por ende nuk dihet nëse opozita i ka votat për rënien e Qeverisë së Rahoyit, shkruan "Reuters". Gjykata shqiptoi dënime të mëdha me burgim për anëtarët

e shquar të Partisë Popullore. Rajoy është kryeministri i parë aktual i Spanjës që është thirrur për të dëshmuar në gjyq. Nga ana e tij, lideri i opozitës spanjolle, Pedro Sanchez, ka thënë se situata e fundit politike

është mjaft e rëndë. Ai ka thënë se Partia Socialiste ka paraqitur një mocion mosbesimi ndaj Rajoyt dhe ka propozuar krijimin e një "agjende sociale" që duhet ta çojë vendin drejt zgjedhjeve të reja.



# Koreja e Veriut, e gatshme për diskutime me ShBA-në

Zëvendësministri i Jashtëm i Koresë së Veriut, Kim Kye Gwan, tha se Pheniani është i hapur për zgjidhjen e problemeve me Shtetet e Bashkuara në çdo kohë dhe me çdo mënyrë

WASHINGTON, 25 MAJ - Zëvendësministri i Jashtëm i Koresë së Veriut, Kim Kye Gwan, tha të premten se vendi i tij është i hapur për të diskutuar me Shtetet e Bashkuara, megjithëse presidenti Donald Trump e anuloi takimin e qershorit me udhëheqësin koreano-verior, Kim Jong Unin. Trumpi e quajti të premten në mëngjes lajm të mirë deklaraten "e ngrohtë dhe produktive" nga Koreja e Veriut. Ai tha në "Twitter" se shpreson se ky qëndrim të sjellë si rezultat begati dhe paqe, por shtoi se vetëm koha do ta tregojë. Ai kishte thënë se e anuloi takimin për shkak të retorikës së ashpër dhe armiqësore nga Pheniani. Në një deklaratë të publikuar nga agjencia koreano-veriore e lajmeve, zëvendësministri i Jashtëm Kim tha se Pheniani është i hapur për zgjidhjen e problemeve me Shtetet e Bashkuara në çdo kohë dhe me çdo mënyrë. Gjithashtu, ai tha se Koreja e Veriut i vlerësonte lart

përprjekjet e presidentit Trump që ai tha se ishin të pashembullta nga çdo president për të realizuar një takim historik në mes të Koresë së Veriut dhe Shteteve të Bashkuara. Trumpi shprehu keqardhje që takimi nuk do të zhvillohet dhe tha se shpreson të mbahet në një rast tjetër në të ardhmen. "Të gjithë koreanët në veri dhe në jug e meritojnë të jetojnë së bashku në harmoni, mirëqenie dhe paqe. Kjo e ardhme e shkëlqyer dhe e bukur mund të realizohet vetëm kur të eliminohet kërcënimi i armëve bërthamore", tha Trumpi. Njoftimi i Trumpit erdhi disa orë pasi Koreja e Veriut çmontoi objektin e provave bërthamore në një shprehje të vullnetit të mirë. Disa analistë e kritikojnë anulimin në një moment të tillë. "Gazetarët ndërkombëtarë ishin të pranishëm për çmontimin dhe anulimin vetëm disa orë më pas", thotë Melissa Hanham. Pheniani ka liruar tre pengje



amerikane gjatë një vizite të sekretarit të Shtetit, Mike Pompeo, por Koreja e Veriut reagoi ashpër ndaj asaj që udhëheqësit e saj e konsideruan një krahasim me Libinë e cila hoqi dorë nga programi i saj i dobët bërthamor në vitin 2003. Ndryshe nga Libia, Koreja e Veriut ka armë bërthamore. Disa analistë thonë se Shtëpia e Bardhë e përdori zemërimin e Koresë së Veriut, si justifikim për

të hequr dorë nga takimi i nivelit të lartë. "Sipas mendimit tim, nënpresidenti Mike Pence dhe këshilltari për sigurinë kombëtare, John Bolton, kishin përgatitur terrenin këto dy javë për mundësinë e anulimit të takimit. Dhe e bënë këtë duke thënë gjëra të tilla si 'ne presim që koreano-veriorët të bëjnë të njëjtën gjë si Moammar Gadafi në Libi, pra të heqë dorë nga programi bërthamor", thotë James

McKeon, i Qendrës për Kontrollin e Armëve dhe Mospërhapje Bërthamore. Analistët në përgjithësi janë në një mendje se Shtetet e Bashkuara dhe Koreja e Veriut kanë këndvështrime të ndryshme për asgjësimin e armëve bërthamore dhe se bisedimet e ardhshme të mundshme për këtë temë kanë nevojë për përgatitje të detajuara dhe pa bujë.

## Klima e biznesit në Gjermani mbetet e qëndrueshme



Berlin, 25 maj - Besimi i bizneseve gjermanë ka mbetur i qëndrueshëm gjatë muajit maj, pas rënies për 5 muaj radhazi, duke treguar se ndjesia e ekzekutivëve në ekonominë më të madhe të Evropës është pozitive, pavarësisht prej mundësisë së një lufte tregtare. Instituti i hulumtimeve mbi ekonominë, IFO, bëri të ditur se indeksi i klimës së biznesit mbeti i qëndrueshëm në 102.2 pikë, pak sipër projeksioneve të analistëve. Sipas analistëve të institutit,

ekonomia e brendshme, kryesisht tregtia, ndërtimi dhe shërbimet, ishin faktorët që sollën stabilizimin, ndërkohë që nuk kishte ndonjë optimizëm për eksportet. Megjithatë, trendi rënës i treguesit mbi bizneset nuk ka përfunduar ende. Sipas analistëve, mundësia e tarifave në importe për automjetet nga Shtetet e Bashkuara si dhe shqetësimet mbi Qeverinë e re italiane, pritet të ndikojnë në sondazhet e muajve të ardhshëm. Gjermania, që është një vend i

madh eksportues, përballet me një serë rreziqesh, përfshirë tarifën e ShBA-së për çelikut dhe aluminin dhe mundësia e sanksioneve për firmat vendase që bëjnë biznes me Iranin, ndërkohë që Amerika u tërhoq nga pakti bërthamor. Të dhëna të tjera gjatë kohëve të fundit kanë formuar një panoramë negative, ndërkohë që rritja ekonomike është ngadalësuar dhe ndjesia e investitorëve dhe konsumatorëve është përkeqësuar.

## Turqia arreston 51 militantë të IS-it

Ankara, 25 maj - Policia turke ka bërë me dije se të paktën 51 militantë të dyshuar të ashtuquajturit Shteti Islamik janë arrestuar. Në një deklaratë të lëshuar nga Policia turke thuhet se

Njësitë Anti-Terrorizëm bastisi 16 vende të ndryshme në qytetin e Stambollit, duke arrestuar të dyshuarit që, sipas policisë, janë "luftëtarë të huaj". "Të gjithë të arrestuarit janë shtetas të huaj",

thuhet në deklaratën e policisë, duke mos cekur se nga cilat shtete janë të dyshuarit. Të gjithë të dyshuarit planifikonin të udhëtonin në "zonat e konfliktit".

Turqia ka pësuar një sërë sulmesh vdekjeprurëse nga militantët e IS-it, duke përfshirë edhe sulmin e vitit të ri në një klub nate në Stamboll në fillim të vitit 2017, në të cilin janë vrarë 39 veta.





E rrallë

# Kali më i vogël në botë

Quhet Thumbelina dhe është kali më i vogël në botë. Në vitin 2002 hyri në rekordet Guinness, pasi u mat dhe doli që ishte i lartë vetëm 44.5 cm. Thumbelina, e gjinisë femërore, lindi në St Louis në Missouri. "Kur ajo lindi ishte vetëm 15.24 cm e gjatë", ka treguar për "CNN" padroni i kalit Michael Goessling.



## BARSOLETA E DITËS



Gjyqtari e pyet dëshmitarin:  
- E dini se ç'do të fitoni me dëshmi të rrejshme.  
- Po, e di. I akuzuari ma ka premtuar një automobil.



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit në ora 15:00

## "AVENGERS: Infinity War" 3D,

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 29 min

**Rolet:** Robert Downey Jr., Chris Hemsworth, Mark Ruffalo, Chris Evans, Scarlett Johansson, Tom Holland, Zoe Saldana, Josh Brolin, Chris Pratt, etj.

**Regjia:** Anthony Russo, Joe Russo



FOTO E DITES



Një punonjës indian mysliman shihet duke përpunuar ngjyra në Rajasthan. /AFP/

Në ora 18:00

## "ISLE OF DOGS"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

**Rolet:** F. Murray Abraham, Bryan Cranston, Greta Gerwig, Jeff Goldblum, Akira Ito, Scarlett Johansson, Harvey Keitel, Frances McDormand, Bill Murray, Yoko Ono, Liev Schreiber, Fisher Stevens, Tilda Swinton, etj.

**Regjia:** Wes Anderson



Në ora 16:00 dhe 20:00

## "DEADPOOL 2" (R)

Aksion/Aventurë/Komedi; 1 ore 59 min

**Rolet:** Ryan Reynolds, Josh Brolin, Morena Baccarin, Julian Dennison, Zazie Beetz, T.J. Miller, Brianna Hildebrand, Jack Kesly, etj.

**Regjia:** David Leitch

Gjate vikendit 19 dhe 20 maj, "DEADPOOL 2" do te shfaqet ne ora 13:00 dhe 20:00.



E jashtëzakonshme

# Martesa që zgjati vetëm 15 minuta

Një burrë u divorcua nga gruaja vetëm pas 15 minutave pasi u martuan. Ndarja ndodhi pas ceremonisë së kurorëzimit, pasi burri u ndje i ofenduar nga kërkesa e babait të nuses për ta paguar çmimin që ishin marrë veshë. Burri ishte pajtuar që ndaj vjehrrit të paguante 20 mijë funte për martesën në Dubai, por që i moshuari kishte humbur durimin derisa kërkonte paratë.




Në ora 22:00

## "I FEEL PRETTY"

Komedi; 1 orë 50 min

**Rolet:** Amy Schumer, Michelle Williams, Rory Scovel, Emily Ratajkowski, Aidy Bryant, Busy Phillips, Tom Hopper with Naomi Campbell, Lauren Hutton, etj.

**Regjia:** Abby Kohn & Marc Silverstein



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).



**DASHI**

Sot mbase do t'ju tërheqë një ndjenjë që do të tregojë në të ardhmen se është shumë më e fortë sesa që mendoni.



**DEMI**

Kjo nuk është dita juaj dhe jeni gjithë kohës nën stres. Do të mundoheni t'i menaxhoni emocionet, por shumë e vështirë të ndodhë.



**BINJAKËT**

Jeni të rrethuar nga njerëz pozitivë dhe që mendojnë vetëm për të mirën tuaj. Kjo gjë ju shtyn të veproni më të sigurt.



**GAFORRJA**

Ditën e sotme keni nevojë për siguri. Këtë gjë do ta kërkoni si nga kolegët e punës, po ashtu dhe nga partneri.



**LUANI**

Një ndjesi plogështie do t'ju shoqërojë sot gjatë gjithë ditës. Është mirë të bëni një kontroll për të parë që çdo gjë shkon mirë me fizikun tuaj.



**VI R G J Ë R E S H A**

Edhe pse ju duket sikur të tjerët nuk do t'ju vijnë në ndihmë sot për një problem të caktuar, gaboheni. Miqtë tuaj do të jenë aty për ju.



**PESHORJA**

Një debat i ndezur me partnerin që në orët e para të mëngjesit do të ketë pasojat e tij përgjatë gjithë ditës së sotme.



**AKREPI**

Do t'ju thonë një të vërtetë të hidhur sot që do të parapëlqenit të mos e dinit. Respekti për një person do t'ju humbë përgjithmonë.



**SHIGJETARI**

Keni nevojë për qetësi këtë kohë për të menduar më mirë dhe më kthjellët ndryshimet e mëdha që doni të realizoni.



**BRICJAPI**

Merrni kohë në dispozicion për t'ju përkushtuar interesave tuaja dhe familjes. Do të shikoni që ju mungonin këto çaste kënaqësie.



**UJORI**

Sot keni probleme përqendrimit sepse doni t'i zgjidhni disa punë njëherësh. Në fund të ditës do të përfundoni duke shkatërruar gjithçka.



**PESHQIT**

Edhe pse ju kanë dalë disa probleme të vogla financiare kohët e fundit, do të arrini të zgjidhni gjithçka. E rëndësishme është t'i ndani prioritetet.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com

**SPORT**

**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

REAL MADRID - LIVERPOOL

GG3+

DUKLA PRAHA - PLZEN

2

LAHTI - VPS VAASA

1

# Real - Liverpool, beteja për mbret të Evropës

Realit e kërkon trofeun e trembëdhjetë në Ligën e Kampionëve, kurse Liverpooli po synon të gjashtin. Herën e fundit "mbretërit" e fituan vitin e kaluar, kurse Liverpooli kishte triumfuar për herë të fundit në Stamboll në vitin 2005, në finalen ndaj Milanit



## FORMACIONET E MUNDSHME:

**Real Madrid (4-4-2):** Navas; Carvajal, Ramos, Varane, Marcelo; Modriç, Casemiro, Kroos, Asensio; Bale, Ronaldo.  
**Liverpool (4-3-3):** Karius; Alexander-Arnold, Lovren, Van Dijk, Robertson; Wijnaldum, Henderson, Milner; Salah, Firmino, Mane.

kundër 11. Te Liverpooli jemi të gjithë shokë dhe Kloppi është shok me të gjithë ne", ka thënë Salah, i cili, në rast se triumfon në këtë finale, ka gjasa ta fitojë edhe "Topin e Artë".

## Sermaxhaj: Real - Liverpool, ndeshje e paparashikueshme

Ish-futbollisti i Gjilanit, Dritës dhe Prishtinës, Genc Sermaxhaj, që tash është analist i futbollit, për "Epokën e re" e ka bërë një analizë për finalen në mes të Real Madridit dhe Liverpoolit. Ai ka

thënë se është vështirë të parashikohet një ndeshje e tillë, por se Realit e ka përparësi përvojën e madhe, derisa Liverpooli ka shpresa falë formës së mirë të Salahit dhe strategjinë e lojës që e përdorë trajneri Klopp. "Shumë kohë më parë, më 1981, Liverpooli dhe Real Madridi janë takuar mes vete në finale të Kupës së Evropës dhe kishte fituar Liverpool 1-0. Tani në Kiev të Ukrainës këto dy ekipe të mëdha kërkojnë fitoren në një ndeshje të jashtëzakonshme. Realit kërkon trofeun e trembëdhjetë, e Liverpooli të gjashtin, në

një përballje gjigantësh. Realit ka përvojë më të madhe në finale të Ligës së Kampionëve dhe është ekip më i kompletuar me futbollistë superkreativë e imagjnativë, ku ka të gjitha repartet në nivel të duhur. Gjithashtu, Real prej disa muajsh kishte rezervuar forcat për këtë garë, pasi në kampionat ishte dorëzuar me kohë. Liverpooli po shpreson shumë në futbollistin e vet Salah, i cili ka qenë në formë të përkryer këtë stinor, me shënim të shumë golave, të asistimeve dhe të lojës së bukur. Po ashtu, Kloppi ka komponuar një ekip ku ka arritur të krijojë një lojë kolektive, në të cilën po krijon shumë raste shënimi, pas shumë pasimeve të shpejta dhe me kohë", ka thënë Sermaxhaj, duke shtuar: "Do të shohim një ndeshje të shpejtë, shumë të hapur, me shumë raste shënimi. Dëshira për të fituar është maksimale dhe angazhimi do të jetë i padiskutueshëm kur bëhet fjalë për trofe të tillë. Bëhet fjalë për nivelin më të lartë të futbollit dhe përgatitja para kësaj ndeshje është e vetëdijshme nga ekipet dhe futbollistët, ku përqendrimi i tyre është shumë i madh, sepse në ndeshje të tilla vendosin detajet e vogla dhe koncentrimi i tyre është i jashtëzakonshëm. Është ndeshje e paparashikueshme dhe mendoj se do të përballen dy ekipe krejtësisht të ndryshme".

## EPOKA E RE Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 25 MAJ** - Kampioni aktual Real Madrid dhe befasia më e madhe e këtij edicioni në Ligën e Kampionëve, Liverpool, e ndajnë sonte (e shtunë) "mejdantin" për më të mirin në garën më të rëndësishme në futboll. Kjo ndeshje zhvillohet në "Stadion NSK Olimpiyskiy" në Kiev të Ukrainës. Trajneri i Realit, Zinedine Zidane, ka thënë se është e mahnitshme të luftosh për trofeun e tretë radhazi në Ligën e Kampionëve, kurse për të dyja skuadrat beson se e kanë merituar kualifikimin deri në finale. "Nuk e di nëse jemi të barabartë, por ai ekip ka arritur në finale. Kundërshtari e ka merituar të jetë në Kiev ashtu si ne. Puna ime është ta përgatis sa më mirë ndeshjen, si gjithmonë, duke studiuar edhe të metat e kundërshtarit. Të luftosh për të tretin trofe radhazi për Ligën e Kampionëve është një gjë e mahnitshme. Në fakt, e tillë ishte edhe për të fituar të

parin dhe të dytin për mua si trajner. E vërteta është se këtë edicion kemi luajtur kundër tre kundërshtarëve të nivelit të lartë në Evropë dhe mbërritja në finale ka një vlerë të rëndësishme. Tani është një finale e vetme, për Liverpoolin dhe për ne", ka thënë Zidane. Ndërsa trajneri i Liverpoolit, Jurgen Klopp, i cili po mahnitë të gjithë me atë që po tregon me skuadrën angleze, ka pranuar se Realit është favorit në sajë të përvojës, por beson se mund ta fitojë trofeun. "Do të përballemi me skuadrën që ka më shumë përvojë në Ligën e Kampionëve. Por, nga ana tjetër, është vetëm një ndeshje dhe gjithçka mund të ndodhë", ka deklaruar Kloppi. Të njëjtin mendim me trajnerin gjerman ka edhe ylli i Liverpoolit, Mohamed Salah. "Të luash në finalen e Ligës së Kampionëve është një ëndërr që bëhet realitet dhe ta fitosh do të ishte një arritje e jashtëzakonshme. Real Madridi ka shumë përvojë, por është një ndeshje finale dhe e kaluara nuk ka të bëjë. Luajmë 11

# Sejdiu braktis Vëllaznimitin para finales së Kupës



## EPOKA E RE Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 25 MAJ** - Trajneri Gani Sejdiu nuk do të jetë në krye të Vëllaznimitit në ndeshjen finale të Kupës ndaj Prishtinës, e cila zhvillohet të dielën në stadiumin "Adem Jashari" në Mitrovicë. Lajmin për largimin

e Sejdiut për "Epokën e re" e ka konfirmuar vetë trajneri mitrovicas. "Jo, nuk do të jem në krye të Vëllaznimitit për finalen e Kupës. Është e pakuqteshme të mbes në klub pas rënies nga Superliga. Për këtë e kam njoftuar edhe kryetarin Agim Cana", ka thënë Sejdiu, i cili, pas ndeshjes së barazhit ndaj

Ferizajt, deklaroi se është munduar në këtë kohë ta japë maksimumin si trajner i Vëllaznimitit, kurse rënia nga elita ishte momenti më i rëndë në jetën e tij. Ndryshe, Gani Sejdiu vlerësohet ndër trajnerët më të mirë në Kosovë, pasi e ka fituar titullin e kampionit me Trepçën dhe me Feronikelin.

## Kampionët e Dritës priten nga kryeministri Haradinaj

**PRISHTINË, 25 MAJ** - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur në takim përfaqësuesit e Klubit të Futbollit "Drita" të Gjilanit. Haradinaj Klubit të Gjilanit i ka dhënë dekoratën e Hartës së Kosovës. Klubi i Futbollit "Drita" javë më parë është shpallur kampione e Kosovës për sezonin 2017/18. Për ta shpallur kampione Dritës i mjaftoi barazimi

kundër Prishtinës në xhiron e fundit, ndeshje që u mbyllë 0-0 në stadiumin "Shani Haxhiislami". "Drita e Gjilanit e fitoi titullin në një kampionat që ka shënuar ngritje në cilësi dhe organizim. Sikur ditën kur ua dorëzova kupën e kampionit, ishte nder edhe sot t'i pres në takim futbollistët gjilanas. Me këtë rast, shpreha respektin tim për themeluesin e kësaj skuadre,

mikun tim të ndjerë Selami Osmani-Bezi, për kontributin e tij të çmuar për avancimin e sportit në vendin tonë. Puna e madhe, profesionalizmi dhe përkushtimi në fushën e sportit janë dëshmi e angazhimit të fuqishëm së sportistëve tanë që flamuri i Kosovës të vazhdojë të ngrihet sa më lart edhe në arenat ndërkombëtare", ka thënë Haradinaj.





## Publikohet kënga e "Rusi 2018". Era Istrefi, në krah të Will Smithit e Nicky Jamit

MOSKË, 25 MAJ - Ashtu siç ishte bërë me dije, 25 maji ka shënuar edhe zyrtarizimin e hitit më të ri dhe atij që do ta simbolizojë Botërorin e futbollit që do të zhvillohet në më pak se tri javë në Rusi. Këngëtarja e mirënjohur nga

Kosova, Era Istrefi, në bashkëpunim me Will Smithin dhe Nicky Jamin, kanë bashkuar forcat për ta sjellë superhitin e kësaj vere. "Live it Up" është një këngë që e ka të garantuar suksesin gjatë kësaj vere, falë të qenit ritmike, në

qendër të vëmendjes, për shkak të futbollit, sportit më të përhapur në mbarë botën, gjithashtu për pjesëmarrësit në të. Prodhim i producentit Diplo, kënga është e gjitha në anglisht, por ajo që të bie në sy është zëri kumbues i Era

Istrefit në refren. Kënga është publikuar në "Youtube" nga Nicky Jam, thjesht si kolonë zanore, por për herë të parë do të ekzekutohet në finalen e Botërorit, duke pasur të garantuar shikueshmërinë e tejskajshme.



## 5 000 fëmijë të vitit të pavarësisë shënuan Ditën Olimpikë 2018

PRISHTINË, 25 MAJ - Rreth 5 000 fëmijë të lindur në vitin e pavarësisë së Kosovës (2008) kanë shënuar sot Ditën Olimpikë 2018. Organizuar nga Komiteti Olimpik i Kosovës, aktiviteti në vrapim u mbajt për herë të parë në shtatë qendrat e Kosovës: Prishtinë, Gjiilan, Mitrovicë, Gjakovë, Pejë, Prizren dhe Ferizaj. Rreth 2 500 fëmijë ishin të pranishëm në Prishtinë, të cilët vrapuan nga Sheshi "Zahir Pajaziti" deri tek Teatri. Tri vendet e para në konkurrencën e femrave i zunë: Medina Fejza nga shkolla "7 marsi", që doli e para për të tretin vit, e dyta Dea Halimi nga "Elena Gjika" dhe Medina Bilalli nga "Zenel Hajdini" ishte e treta.



Tek djemtë, i pari doli Engjëll Shehu nga shkolla "Mileniumi i Tretë", i dyti Rin Ahmeti nga "Hasan Prishtina", ndërsa pozitën e tretë e ndanë Eduart Haliti dhe Jon Ramadani të "Zenel Hajdinit". Pas vrapimit, qindra fëmijë provuan për herë të parë edhe sportin e pentatlonit modern, ku patën rastin të garojnë në disiplinën qitje me pistoletë laserike. Për të gjithë pjesëmarrësit organizatorët dhanë medalje.

Pjesëmarrje të madhe pati edhe në Komunën e Gjiilanit, ku për herë të parë KOK-u organizoi Ditën Olimpikë. Në të morën pjesë mbi 700 fëmijë. Edhe në

Gjakovë u organizua Dita Olimpikë, në të cilën mori pjesë edhe kryetari i Komunës, Ardian Gjini, i cili i përshëndeti rreth 300 fëmijë dhe apeloj tek prindërit dhe mësuesit që t'i nxisin fëmijët e tyre të merren me sport. Vendin e parë në Gjakovë e zuri Glenis Dina, të dytin Ideal Plava, të tretin Aulon Hoxha.

Në konkurrencën e femrave, e para doli Viona Kida, e dyta Arlinda Isufi, vendi i tretë shkoi për Erjona Nuzën.

Rreth 300 filloristë nga disa shkolla të qytetit të Mitrovicës, të lindur në vitin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës, shënuan

Ditën Olimpikë 2018 në Mitrovicë. Për herë të parë Dita Olimpikë u shënuar edhe në Ferizaj, ku morën pjesë mbi 200 fëmijë. Pjesëmarrës ishin nxënësit e shkollave fillore të qytetit të Ferizajt, ndërsa u ndanë 20 medalje për 10 më të mirët. Ndërsa Sheshi i Prizrenit, i njohur si Shadërvani, gufoi me fëmijët e lindur në vitin e pavarësisë së Kosovës (2018). 130 sosh, të ndarë sipas gjinisë, vrapuan në gjatësi prej 550 metrave, nga Shtëpia e Bardhë drejt Shadërvanit. Edhe Peja ishte pjesë e organizimit të Ditës Olimpikë 2018. 600 fëmijë vrapuan në sheshin e Pejës.

## Houstoni, afër titullit në Perëndim

HOUSTON, 25 MAJ - Skuadra kampione e Golden State rrezikon ta dorëzojë titullin kampion në NBA, pas humbjes 98-94 ndaj Houstonit në finalen e 5-të të "play-off"-it në Konferencën e Perëndimit. Skuadra e Rocketsit tashmë udhëheq 3-2 serinë e finaleve dhe është një fitore larg titullit kampion në Perëndim, në një ndeshje me rivalitet dhe emocione deri në fund. Një ndeshje me dy pamje, më e mirë për Warriorsin në pjesën e parë, ndërsa në të dytën loja ishte e ekuilibruar dhe me rivalitet, duke e lënë të hapur emrin e fituesit deri në fund. Për Houstonin u aktivizuan vetëm shatë lojtarë, me Gordonin që ishte shënuesi më i mirë, autor i 24 pikëve, ndërsa Pauli e mbylli me 20 pikë e Hardeni me 19 pikë, një treshe që bëri dallimin



në parket. Për skuadrën e Golden States u dalluan Durant me 29 pikë, Thompsoni me 23 dhe Curry me 22, duke mos arritur ta evitojnë këtë humbje,

që mund t'i kushtojë shumë. Ndeshja e radhës do të luhet në fushën e Warriorsit që, për të mos u eliminuar, ka nevojë për fitore.

### SHKURT

#### Shaqiri konfirmon largimin nga Stoke City

Futbollisti shqiptar, Xherdan Shaqiri, ka pranuar se do të largohet nga Stoke City pas rënies së ekipit nga Premierliga. "Nuk është më fshehtësi, të gjithë e dinë se do të largohem. Ende gjithçka është e hapur. I besoj vëllait tim dhe këshilltarëve të mi për këtë çështje. Ata do të përkujdesen për gjithçka. Jam i qetë, sepse do të më informojnë me kohë", ka deklaruar Shaqiri. I pyetur rreth thashethemeve se Tottenhami dhe Roma e kërkojnë, Shaqiri ka thënë: "Ta themi kështu: nuk përjashtoj asgjë. Por, do të doja të qëndroja në Angli. Premierliga më përshtatet. Pse? Sepse është liga më e mirë me lojtarët më të mirë. E thjeshtë është!".

#### Besa, afër ta mbrojë titullin në hendboll

Besa FamGas ka bërë hapin e parë drejt mbrojtjes së titullit të kampionit të Kosovës në hendboll. Në ndeshjen e parë finale të "play-off"-it, Besa FamGas fitoi bindshëm ndaj Prishtinës (37:23). Ekipi vendës ka dominuar prej fillimit të ndeshjes dhe ka shkuar duke e rritur epërsinë deri në fund. Pas pjesës së parë rezultati ishte 18:11 në të mirë të ekipit pejan. Më efikasët ishin Kastriot Jupa e Drilon Tahirukaj me nga shtatë gola. Te Prishtina më së shumti realizoi Deniz Terziqi, 12 gola. Ndeshja e dytë e finales së "play-off"-it luhet në fundjavë në Prishtinë. Besës i duhet edhe një fitore apo edhe një barazim për ta siguruar titullin. Ndërkohë, nëse rezultati barazohet në 1:1, ndeshja e tretë do të luhet në Pejë. Besa e ka përparësinë e terrenit vendës në ndeshjen e tretë eventuale për shkak se në kampionat përfundoi më lart se Prishtina. Besa ishte e para, kurse Prishtina e dyta.

#### Muller: Salahi e meriton 'Topin e Artë'

